



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHËTETËSE

Tiranë, më 31.08.2023

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Vendimit nr. 877, datë 14.12.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, si dhe në VKM nr. 56, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuara si mëposhtë vijon :

I. DREJTORIA PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE

➤ SEKTORI I PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE IPARD, PËR MASËN 3, MASËN 4 DHE MASËN 7

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b.

➤ Detyrat kryesore:

- Analizon nga ana administrative dosjet e aplikantëve për të aprovuar ose jo aplikimet e Masave 3, 4, 7, si dhe programeve të tjerë me financim të huaj, duke zbatuar Legjislacionin përkatës, Manualin e Procedurave dhe Udhëzimet përkatëse.
- Identifikon në mënyrë të vazhdueshme kërkesat/ankesat e deleguara nga eprori lidhur me aplikantët që kanë aplikuar në Masat 3, 4, 7, si dhe programeve të tjerë me financim të huaj.
- Asiston në përgatitjen, përditësimin e dokumentacionit për akreditim, trajnime dhe konsultime mbi përafrimin me standartet europiane në menaxhimin e fondeve.
- Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga eprori përkatës.

➤ Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

1. Diplomë e nivelit “Master Profesional”, Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike/Shkenca Inxhinierike/Shkenca Bujqësore. Edhe diploma Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit

4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
5. Të kenë njohuri të gjuhës angleze.
6. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 37, datë 09.04.2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)";
- Ligjin nr. 30, datë 17.03.2016, "Për ratifikimin e marrëveshjes sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të Be-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit, në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural" (IPARD)";
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike".

II. DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

➤ **SEKTORI I PROTOKOLLIT DHE ARKIVËS**

SPECIALIST PROTOKOLLI (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b.

➤ **Detyrat kryesore:**

- Pranon, evidenton dhe shpërndan korrespondencën zyrtare që vjen në AZHBR si dhe kryen veprimet për nisjen e korrespondencës zyrtare në destinacionin përkatës.
- Shpërndan dokumentet sipas përcaktimit të titullarit.
- Hap dosje sipas pasqyrës emërtuese dhe sistemon gjatë gjithë vitit.
- Sistemon cdo dokument në dosjen përkatëse.
- Mban, ruan dhe administron vulën e Institucionit.

➤ **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

1. Diplomë e nivelit "Bachelor" në Shkenca Shoqërore. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të njehsohen nga institucionet përgjegjëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri të gjuhës angleze.
5. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”;
- Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”.

III. DREJTORIA E AUTORIZIMIT TË PAGESAVE

- **SEKTORI I AUTORIZIMIT TË PAGESAVE IPARD, MASA 1, MASA 3, MASA7 DHE MASA 9.**

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b.

- **Detyrat kryesore:**

1. Realizon kontrollin administrativ të dokumentave të Kërkesës për Pagesë.
2. Përgatit përlllogaritjen e shumës për tu paguar bazuar në dokumentacionin e dërguar me kërkesën për pagesë.
3. Përgatit tabelat e autorizimit me zërat e investimeve të kontraktuar si dhe mbi bazën e faturave, situacioneve, librezën e masave si dhe raportin e kontrollit në terren.
4. Harton kërkesën për dokumenta shtesë kur është e nevojshme, në mënyrë që të arrihet plotësia dhe përputhshmëria e kërkesës për pagesë.
5. Përgatit procesimin e të gjithë aplikimeve që i caktohen në sistemin kompjuterik.
6. Analizon ankesat dhe pretendimet e aplikantëve, kryen verifikimin dhe kthimin e përgjigjeve me sqarimet përkatëse.

- **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

1. Diplomë e nivelit “Master Profesional”, në Shkenca Ekonomike, Shkenca Bujqësore, Shkenca Juridike, Shkenca Inxhinierike dhe Shkenca të Natyrës. Edhe diploma Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
5. Të kenë njohuri të gjuhes angleze.
6. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

- **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 37, datë 09.04.2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)";
- Ligji nr. 30, datë 17.03.2016, "Për ratifikimin e marrëveshjes sektoriale ndërmjet Republikës Së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Europian, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të Be-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit, në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural" (IPARD)".

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 06.09.2023, ora 16.30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL